



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 06.12.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-780

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3, të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke u bazuar në nenin 11 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, me Nr. Prot. 01-197/A, të datës 11.05.2022, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, mori vendim të shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2022/23

I. Kushtet e Përgjithshme

1. Përfitues të bursës universitare do të jenë studentët e nivelit bachelor dhe studentët e nivelit master të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, të cilët i plotësojnë kriteret sipas Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare, me Nr. Prot. 01-197/A, të datës 11.05.2022, si dhe dispozitave të këtij konkursi.
2. Lartësia e bursës do të caktohet me një vendim të veçantë nga Këshilli Drejtues i Universitetit, si parashihet në nenin 3 të Rregullores me Nr. Prot. 01-197/A, të datës 11.05.2022, mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
3. Kriteret për përfitim të bursës studentore janë:
 - 3.1. Të jetë student i rregullt i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren;
 - 3.2. Të jetë student i vitit të dytë e më lartë;
 - 3.3. Të mos ketë vit të përsëritur të studimeve;
 - 3.4. Të ketë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve deri në afatin e shtatorit;
 - 3.5. Të ketë notën mesatare së paku:
 - 3.5.1. Tetë pikë pesë (8.5) – për studentët e nivelit të studimeve Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetin e Shkencave Kompjuterike;
 - 3.5.2. Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët nivelit të studimeve Bachelor të Fakultetit Juridik, Ekonomik, Filologjik dhe të Edukimit;
 - 3.5.3. Tetë pikë pesë (8.5) – për studentët e nivelit të studimeve Master në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetin e Shkencave Kompjuterike;

3.5.4. Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët e nivelit të studimeve Master të Fakultetit Juridik, Ekonomik, Filologjik dhe të Edukimit.

II. Dokumentacioni për aplikim

1. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- 1.1. Formulari i aplikimit;
- 1.2. Formulari i deklaratës nën betim;
- 1.3. Pasqyra e notave;
- 1.4. Kopja e letërnjoftimit e Republikës së Kosovës;
- 1.5. Numri i llogarisë bankare (personale).

2. Formulari për aplikim dhe deklarata nën betim gjenden në faqen zyrtare të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren: <https://www.uni-prizren.com>

III. Afati i aplikimit

1. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën e arkivit (nr. 308), në ndërtesën e Rektoratit. Afati për aplikim është prej datës 07.12.2023 deri më 22.12.2023.

IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej dyzet e tetë (48) orësh, pas publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në zyrën e arkivit (nr. 308), në ndërtesën e Rektoratit.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve dhe në ueb faqen e Universitetit: <https://www.uni-prizren.com>

